**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
-XIII- Nr. i prot / Br. prot. 91 Më / Dt. 15.04.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

**13 Nr. Zyrtar – 2026**
**Me datë: 15.04.2026**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 1047 të datës 05.03.2026, dhe në mbështetje të vendimit me Nr. Prot.7115 të datës 18.03.2026, për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në sport dhe rini nga DKRS-ja për vitin 2026, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Për ndarjen e shumës financiare sipas projekteve për OJQ-të që i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret për subvencionim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, sipas thirrjes publike për aplikim e subvencionim të OJQ-ve në komunën e Rahovecit.
2. Bashkëngjitur me këtë vendim është lista e përfituesve të subvencioneve në sektorin e rinisë dhe sportit.

Lista e OJQ-ve përfituese të subvencioneve në sektorin e sportit dhe rinisë

| | |
|---|---|
| KF Rahoveci | Zhvillimi i sportit dhe përfaqësimi i klubit në ligën e parë |
| KF Xërxa | Zhvillimi i sportit, në futboll |
| KF Drenoci | Zhvillimi i garave në ligën e tretë |
| FC Rahoveci 2019 Futsal | Zhvillimi i garave në futsal |
| KF Anadrini | Ikonat e futbollit Anadrinas 2026 |
| OJQ Sporti Shkollor | Zhvillimi i sportit shkollor në komunën e Rahovecit |
| Klubi Pëllumbave Lartëflutures | Promovimi i sportit të pëllumbave lartëfluturues Rahovec |
| KB Rahoveci 029 | Zhvillimi i basketbollit elitar në Rahovec |
| KV 17 Korriku | Zhvillimi i volejbollit në komunën e Rahovecit dhe pjesëmarrja në gara |
| Shkolla e Futbollit Grape City | Garimi në gara regjionale me 4 gjenerata |
| Shoqata e Çiklistëve Kokrrat | Promovimi i çiklizmit dhe peisazheve natyrore ne Rahovec |
| KH Rahoveci | Pjesëmarrja në garat vendore e ndërkombëtare |

| | |
|---|---|
| Shkolla e Shahut Gani Daka | Superliga e Kosovës 2026-femrat |
| Klubi i Shahut Rahoveci | Superliga e Kosovës në shah 2026 |
| Shoqata e Peshkatarëve Amur | Mbrojtja e ambientit, edukim, trajnim, flora dhe fauna |
| Klubi Boksit Rahoveci | Fuqizimi i të rinjëve për mes boksit |
| Klubi i Veteranëve të Futbollit Rahoveci | Pjesëmarrja në garat zyrtare të ligës së veteranëve në futboll dhe organizimi i turneut memorial "Epopeja e Rahovecit" dhe turneu "Haxhi Korenica" |
| Këshilli Rinor Rahovec | Vlera e trashëgimisë sonë shekullore |
| Vizioni Rinisë për Integrime Sociale | Fuqizimi i rinisë për ndryshim social |
| Organizata Kulturore e të Rinjëve | Jetesa e shëndetit sportiv |
| SHL-Kosova | Iniciativa rinore për lidership dhe angazhim komunitar |

**ARSYETIM**

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, me Nr.prot.7114, të datës 18.03.2026 , është formuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës për vitin 2026.

Komisioni ka bërë hapjen dhe vlerësimin e aplikacioneve të cilët kanë konkuruar për subvencione të DKRS-së, për vitin 2026 duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim.

Nga gjithsej njëzetë e tre (23) aplikacione të pranuara, komisioni ka vlerësuar se kriteret për subvencionim i kanë përmbushur njëzetë e një (21) prej tyre, ndërsa dy (2) janë refuzuar për mungesë dokumentacioni.

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me OJQ-të, përfituese të subvencioneve komunale.

**Udhëzim Juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e rinisë dhe sportit .

**Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës.**

**Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:**

1. Qemajl Krasniqi – Kryesues - ____________________
2. Lahuta Dula – Anëtare - ____________________
3. Luan Danuza - Anëtar - ____________________
4. Shqipe Tara - Anëtar - ____________________
5. Senad Alirifa – Anëtar ____________________